



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

FLETINFORMACION

PËR ÇËSHTJEN

Numri i çështjes:
KSC-BC-2020-04/KSC-CA-2024-03

Prokurori i Specializuar kundër:



Pjetër Shalës

Faza e çështjes:
PËRFUNDIMI I APELIT

I AKUZUARI/AKUZAT

PJETËR SHALA

Datëlindja: 17/09/1963

Funksionet gjatë periudhës së mbuluar prej Aktakuzës:

- Anëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) i vendosur në ish-fabrikën e metalit në Kukës, Shqipëri. Sipas Aktakuzës, kjo fabrikë shërbeu edhe si qendër për ndalimin dhe marrjen në pyetje të personave të cilët dyshoheshin se kishin bashkëpunuar me Republikën Federale të Jugosllavisë (RFJ) dhe Serbinë, apo se nuk përkrahnin UÇK-në.

Përshkrimi i akuzave

Kjo çështje ka të bëjë me veprimet e Pjetër Shalës në bazën e UÇK-së në Kukës, afërsisht midis 17 majit dhe 5 qershorit 1999.

Sipas Aktakuzës, pretendohet se gjatë kësaj periudhe Pjetër Shala dhe disa ushtarë, policë e roja të UÇK-së patën të njëjtin qëllim të përbashkët të marrjes në pyetje dhe keqtrajtimit të të ndaluarve në fabrikë. Qëllimi i përbashkët përfshinte krimet si në vijim. Sipas Aktakuzës, viktimat e këtyre krimeve ishin të gjithë shtetas të RFJ-së dhe persona të cilët nuk merrnin pjesë aktivisht në luftime.

Format e përgjegjësisë

Ndërmarrje kriminale e përbashkët
Kryerje e drejtpërdrejtë
Ndihmë dhe inkurajim

Akuzat

1. Ndalim arbitrar (krime lufte)
2. Trajtim mizor (krime lufte)
3. Torturë (krime lufte)
4. Vrasje e paligjshme (krime lufte)

DËNIMET/ZHDËMTIMET

Aktgjykimi i Trupit Gjyqes, 16 korrik 2024

Trupi Gjyqes shpalli fajtor Pjetër Shalën për krime lufte të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes së paligjshme (1,3 dhe 4) ndërsa e shpalli të pafajshëm për krimin e trajtimit mizor (pika 2). Sa i përket formave specifike të përgjegjësisë, Shala u shpall fajtor për këto tri pika si pjesëmarrës në ndërmarrjen e përbashkët kriminale.

Dënimi: 18 vjet burgim

Urdhri për zhdëmtim, 29 nëntor 2024

Trupi Gjyqes urdhëroi P. Shala të paguajë një shumë prej **€208,000** si zhdëmtim për dëmin fizik, mendor dhe material të shkaktuar viktimave të krimeve për të cilat është shpallur fajtor.

Aktgjykimi i apelit, 14 korrik 2025

Paneli i Apelit la në fuqi verdiktin e fajësisë së Shalës për pikat 1, 3 dhe 4 por miratoi, pjesërisht, tri pika që Shala paraqiti në apel dhe uli dënimin e tij.

Dënimi: 13 vjet burgim

KRONOLOGJIA

Pas arrestimit të tij në Belgjikë, Shala u transferua në njësinë e paraburgimit të Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë më 15 prill 2021.

Më 19 prill 2021, ai u vetëdeklarua i pafajshëm për të gjitha pikat e Aktakuzës.

Gjykimi filloi më 21 shkurt 2023 dhe zgjati deri më 17 prill 2024.

Më 16 korrik 2024, Trupi Gjykues shpalli Shalën fajtor dhe e dënoi me 18 vjet burg.

Urdhri i Zhdëmtimeve në lidhje me viktimat u shpall më 29 nëntor 2024. Trupi Gjykues urdhëroi P. Shalën që të paguajë një shumë prej €208,000 si zhdëmtim për dëmin fizik, mendor dhe material të shkaktuar viktimave të krimeve për të cilat ai është shpallur fajtor.

P. Shala apeloj kundër Aktgjykimit dhe rrjedhimisht, Kryetari i DHSK-së caktoi Panelin e Gjykatës së Apelit për të vendosur mbi apelin. ZPS-ja nuk e ka apeluar Aktgjykimin.

P. Shala ka apeluar gjithashtu edhe Urdhrin për Zhdëmtim dhe Paneli i njëjtë do të vendosë lidhur me këtë apelim.

Më 14 korrik 2025, Paneli i Apelit zvogëloi dënimin nga 18 në 13 vjet burgim.

STATISTIKAT E ÇËSHTJES

Kohëzgjatja e procedurës paraprake	22 muaj e 6 ditë
Numri i ditëve të gjykit në sallën e gjyqit	44
Numri i dëshmitarëve gjatë gjykit	10 (ZPS), 2 (Mbrojtësi i Viktimave), 10 (Mbrojtja)
Numri i dëshmive me shkrim/raporteve	7 (ZPS), 4 (Mbrojtja)
Numri i viktimave pjesëmarrëse	8
Kohëzgjatja e gjithsejtë në Gjykatën Themelore	39 muaj
Kohëzgjatja e çështjes në apel	10 muaj 13 ditë

TË CAKTUAR NË KËTË ÇËSHTJE

GJYKATËSI I PROCEDURËS PARAPRAKE



Gjykatës Nikola Giju

TRUPI GJYKUES I



Gjykatëse Mapi
Feld-Folia (kryesuese)



Gjykatës Roland Dekers



Gjykatës Zhilber Biti



Gjykatës Vladimir Miku-
la (gjykatës rezervë)

PANELI I GJYKATËS SË APELIT



Gjykatëse Mishelë Pëkar
(kryesuese)



Gjykatës Kai Ambos



Gjykatëse Nina Jorgensen

ZYRA E PROKURORIT TË SPECIALIZUAR (PËRFAQËSUESIT KRYESORË)



Filipo De Miniçis



Sara Klentën

MBROJTJA (PËRFAQËSUESI KRYESOR)



Zhan-Lui Zhilisen

MBROJTËSI I VIKTIMAVE



Sajmon Loz

Për më shumë informacion përdorni kamerën e telefonit tuaj
për të skanuar kodet e mëposhtme:




Faqja e çështjeve gjyqësore




Kalendari i gjykatës



Faqja e aktualiteteve



Kanali Youtube i DSHK-së



Profili X i DSHK-së



Profili Instagram i DSHK-së



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEĆA KOSOVA



DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS / FLETINFORMACION PËR ÇËSHTJEN